



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1670/14 Prot

Tiranë, më 29/12/2014

V E N D I M

Nr. 11, datë 29/12/2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*Albsig*"sh.a Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të urdhrin nr. 155, datë 02.10.2014 është ushtruar kontroll administrativ pranë subjektit juridik "*Albsig*"sh.a. Kontrolli ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit dhe është njoftuar paraprakisht me objekt: "*Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij*".

"*Albsig*"sh.a është person juridik jopublik, që operon në tregun e sigurimeve bazuar në ligjin nr. 52/2014 "*Për veprimtarinë e sigurimit, dhe risigurimit*" dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tij nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). "*Albsig*"sh.a, gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Nga kontrolluesi "*Albsig*" sh.a është shkelur detyrimi i përcaktuar nga neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave personale "klientë" në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale, qëllimin e përpunimit, mënyrën si do të përpunohen të dhënat, si dhe të drejtat e subjektit për të pasur akses apo për t'i korrigjuar ato. Ky informim nuk realizohet në policat e detyrueshme, si dhe në policat jo të detyrueshme (vullnetare).

Gjithashtu, për kontrolluesin "*Albsig*"sh.a është kryer inspektimi i faqes së tij në internet www.albsig.com.al dhe në përfundim është dërguar Rekomandimi nr.70 datë 25.08.2014 i Komisionerit. Kontrolluesi nuk ka marrë masa për zbatimin e Rekomandimit lidhur me

publikimin e rubrikës “politikat e privatësisë” me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Mos realizimi i detyrimit ligjor për informim nga kontrolluesi i mohon subjekteve të të dhënave personale të drejtën për tu informuar lidhur me të dhënat personale që ata deklarojnë pranë kontrolluesit, përpunimin e të dhënave të tyre personale, qëllimin e përpunimit, mënyrën si do të përpunohen të dhënat, të drejtat e subjektit për të patur akses apo për t'i korrigjuar ato, si dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më i shpejtë që të jetë e mundur. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

2. Nga kontrolluesi “Albsig” sh.a është shkelur neni 5/1 pika ‘d’, si dhe neni 27/4 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

“Albsig” sh.a mban në arkivat e tij dosje të punonjësve të larguar prej vitesh nga puna të cilat mbartin dokumente me të dhëna personale të tyre, këto të dhëna mbahen tej kohës sa është qëllimi për të cilin ato janë mbledhur dhe përpunuar, këto dokumente nuk janë tërhequr nga subjektet e të dhënave personale.

Të dhënat personale të punonjësve grumbullohen, përpunohen dhe përdoren vetëm për qëllime të krijimit, implementimit, ndërprerjen ose administrimin e marrëdhënieve midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kontrolluesi mund t'i mbajnë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa ata kanë nevojë për to, lidhur me qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur dhe përpunuar më tej. Me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të dhënat e punonjësve nuk janë më të nevojshme për këtë qëllim.

3. Nga kontrolluesi “Albsig” sh.a është shkelur neni 5/1/c i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 3 datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar.

“Albsig” sh.a përdor sistemin e vëzhgimit me kamera CCTV ne ambiente të tilla si: zyra e degës Tiranë, zyra e administratës, zyra e dëmeve, zyra e sekretares dhe e zv/drejtorit në të cilat punonjësit vëzhgohen gjatë gjithë kohës së punës duke ndikuar kështu në privatësinë e punonjësve. Kontrolluesi përdor këtë sistem për qëllim sigurie të pronës dhe punonjësve. dhe nuk ka hartuar rregulla të përfshira në “ Rregulloren e Brendshme” apo në një rregullore të veçantë për përdorimin e këtij sistemi.

4. Nga kontrolluesi “Albsig” sh.a është shkelur neni 21 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar .

Në “Formularin e Njoftimit” nga “Albsig” sh.a:

- nuk është deklaruar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale për kategoritë “nëpunës” dhe “aksionerë”.
- nuk është deklaruar mbledhja e dokumenteve “formimi-diplomat-medaljet” për kategorinë “nëpunës”.
- nuk është deklaruar qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale “menaxhim të burimeve njerëzore” për kategorinë “nëpunës”, si dhe nuk është deklaruar mbledhja e të dhënës personale “Imazhe” nëpërmjet kamerave të Vëzhgim-Regjistrimit(CCTV).
- nuk është deklaruar përhapja e të dhënave për “Auditin e jashtëm”.

Formulari i njoftimit duhet të plotësohet me saktësi dhe vëmendje maksimale nga kontrolluesi i cili duhet të deklarojë në vazhdimësi lidhur me përpunimet e reja të të dhënave personale që ai kryen, duke kontribuar kështu në transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me datë 03.12.2014 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Në këtë seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i kontrolluesit dhe u administruan pretendimet me shkrim.

Në këto pretendime kontrolluesi pranon që konstatimet e grupit të kontrollit janë të sakta, nuk kundërshton faktin që shkeljet janë kryer, si dhe raporton për marrjen e masave lidhur me plotësimin detyrimeve ligjore të konstatuara nga kontrolli administrativ i kryer pranë tyre. Kontrolluesi ka vlerësuar këtë kontroll dhe ka marre masa konkrete për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- Lidhur me informimin që kërkohet në policat e sigurimit, ka reaguar menjëherë duke kërkuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS) ndërhyrjen në policat e sigurimit të detyrueshme.

Në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” përcaktohet se, policat e sigurimit hartohen nga kontrolluesi dhe nuk ka më detyrim që këto polica të miratohen nga BSHS dhe Autoriteti Mbikëqyrës Financiar (AMF). Kontrolluesi ka detyrë vetëm të informojë AMF për modelet e policave që ai përdor.

- Kontrolluesi ka plotësuar rubrikat në formularin e njoftimit. Formulari i njoftimit i përditësuar është dorëzuar pranë Komisionerit me datë 03.12.2014.
- Kontrolluesi ka vendosur rubrikën “Politikat e Privatësisë” në faqen e tij në internet www.albsig.com.al.
- Është lenë detyre që pas largimit nga puna të punonjësit, në dosjet e tyre të punës nuk duhet të mbahen të dhëna personale. Kjo detyrë është në proces.
- Kontrolluesi ka hartuar draft-rregullore “Për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale”, si dhe draft-rregullore “për përdorimin e sistemit të CCTV”, të cilat do të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Si përfundim konkludoj se; shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar përbëjnë “kundërvajtje administrative” dhe sanksionohen me gjobë.

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për informim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me seriozitetin e zbatimit të detyrave që dalin nga Rekomandimet e Komisionerit, zbatueshmërinë e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 39 /2 në të cilin parashikohet se; “Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, faktin që kontrolluesi bashkëpunues gjatë ushtrimit të këtij kontrollit administrativ dhe ka marrë masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARËSYE:

Në zbatim të neneve 29, 30, 32, 9/1/a, 39/1/b, 39/1/d, 39/2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Albsig”sh.a me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyre të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

